

Kjo agjendë është mjeti më i mirë i komunikimit midis shkollës dhe familjes. Ajo i mundëson nxënësit organizimin e veprimtarive të veta dhe prindërve ndjekjen në mënyrë të rregullt të punës së fëmijës së tyre.

Nxënësi e sjell agjendën në shkollë dhe shënon në të detyrat e veta. Mësuesit-et shënojnë aty rezultatet e vlerësimit. Ata-ato mund të shënojnë aty edhe informacione të shkollës, si komentet mbi punën apo sjelljen e nxënësit, si dhe njoftime mbi ngjarje të veçanta.

Prindërit e nënshkruajnë agjendën çdo javë. Ata dëshmojnë kështu se kanë marrë dijeni për informacionet që gjenden në të. Për komentet e tyre është rezervuar një hapësirë e veçantë.

Për formën, natyrën dhe sasinë e shënimeve të bëra në agjendë duhet të tregohet një vëmendje e veçantë. Dialogu lejon komunikimin lidhur me shkollimin e nxënësit, në mënyrën më të plotë e më të hollësishme. Prindërit dhe mësuesit-et mund të kërkojnë takim në çdo kohë. Kërkesa mund të bëhet përmes rubrikës «Demande d'entretien» (Kërkesë takimi).

Ka edhe mënyra të tjera që u mundësojnë prindërve informimin për çka ndodh në shkollë, siç janë seancat e informimit kolektiv.

Rregullat e jetës në klasë, në stabiliment, në shkollë

Çdo klasë apo stabiliment mund të hartojë rregullat e veta të jetës në bashkësi, në harmoni me Ligjin për arsimin e detyrueshëm dhe rregulloren e zbatimit të tij. Këto rregulla ndodhen në faqet 8 e 9 (« Les règles de vie »).

Justifikimi i mungesave dhe kërkesa e lejes (« Justification d'absence et demande de congé »)

Kushtet lidhur me mungesat dhe lejet individuale të nxënësve, si dhe formularët për justifikimin e mungesave dhe për kërkesën e lejeve gjenden në faqen 104 dhe ato pasuese.